VENDIM
Nr. 181, datë 20.3.2025

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 19, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2025, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, përmendur në pikën 1, të vendimit nr. 19, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore", në ndarjen "Gr. 16, Ministria e Brendshme", shtohet nënndarja përkatëse, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme të depozitojë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve me kontratë së bashku me kategorinë e pagës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Gr.	**Emri i institucionit**	**Nr. i punonjësve 2025**	**Emërtesa**	**Koha mesatare ditore**	**Periudhë kohore**
16	**Ministria e Brendshme**	**3**			
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	3	Teknik i mesëm	8 orë/ditë	1.3.2025–31.5.2025